



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 14 paragrafi 7 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja; dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lumbardhë i Pejës, të tipit me kaskad, me kapacitet të instaluar prej 3.1 MW, në lokacionin Kuqishtë (Mini-Hidrocentrali-Rugova), komuna e Pejës, të datës 14.01.2015, të shoqërisë N.T.SH.“RIMED”, me adresë magjistranja Prishtinë-Ferizaj “Laplja Selo”, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 20 shkurt 2015 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_497_2013 i datës 23 janar 2013, edhe për një afat gjashtë (6) muaj, gjegjësisht **deri me 23 korrik 2015**.

A r s y e t i m

- o ZRRE, me datë 29.04.2011 nga shoqëria N.T.SH.“RIMED”, ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lumbardhë i Pejës, të tipit me kaskad, me kapacitet të instaluar prej 3.1 MW, në lokacionin Kuqishtë (Mini-Hidrocentrali-Rugova), komuna e Pejës.
- o Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- o Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (2) dy vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqëria N.T.SH.“RIMED”, do t'i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- o ZRRE me datë 14.01.2015 nga shoqëria N.T.SH.“RIMED”, ka pranuar Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lumbardhë i Pejës, të tipit me kaskad, me kapacitet të instaluar prej 3.1 MW, në lokacionin Kuqishtë (Mini-Hidrocentrali-Rugova), komuna e Pejës, edhe për një afat shtesë sipas legjislacionit në fuqi.



- Shoqëria **N.T.SH.“RIMED”**, në kërkesë e saj ka sqaruar se: si pasojë e vështirësive të dala gjatë projektimit të HC Kuqishtë (studimi i fizibilitetit, raporti hidrologjik, raporti Gjeologjik-inxhinjerik, projekti i HC-së dhe projekti energjetik) si dhe pengesave të dala gjatë studimeve në teren, kanë ardhur në vonesat për realizimin final të projektit.
- Gjithashtu ka sqaruar se shoqëria N.T.SH. RIEMD dhe ekzekutuesi i para-kontraktuar i punëve ndërtimore pas finalizimit të saktë, nëse iu lejohet shtyrja e afatit për fillimin e punëve edhe për disa muaj, janë të gatshëm për fillimin, ekzekutimin dhe përfundimin e këtij projekti. Andaj, kanë kërkuar që t’iu mundësohet shtyrja e afatit të autorizimit preliminar për fillimin e punëve edhe për gjashtë (6) muaj, ku brenda të cilit afat do të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe do të fillojnë ndërtimin.
- ZRRE pas analizimit të kërkesës për shlyerje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, ka vlerësuar ato dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

V. Shoqëria **N.T.SH.“RIMED”**, duhet të bëjë kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lumbardhë i Pejës, të tipit me kaskad, me kapacitet të instaluar prej 3.1 MW, në lokacionin Kuqishtë (Mini-Hidrocentrali-Rugova), komuna e Pejës, deri me datën **23 korrik 2015** duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.

VI. Pas skadimit të afatit të cekur më lartë, Vendimi V-497-2013 i datës 23 janar 2013 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, do të shfuqizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do të shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.

VII. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.


VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar